

**KONVENTA KUADËR
PËR MBROJTJEN E PAKICAVE KOMBETARE
DHE RAPORTI SHPJEGUES**

Konventa Kuadër “Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare”

Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës dhe shtetet e tjera, nënshkruese në këtë Konventë Kuadër,

Duke konsideruar se synimi i Këshillit të Evropës është arritja e një uniteti më të madh ndërmjet anëtarëve të tij, me qëllim që të rmbrojnë dhe realizojnë idealet e parimet, që përbëjnë trashëgiminë e tyre të përbashkët;

Duke gjykuar se një prej metodave për arritjen e këtij qëllimi është ruajtja dhe realizimi i mëtejshëm i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore;

Duke dashur që të zbatojnë Deklaratën e Kryetarëve të Shteteve dhe Qeverive të Shteteve Anëtare të Këshillit të Evropës, miratuar në Vjenë, më 9 tetor 1993;

Të angazhuar për të mbrojtur ekzistencën e pakicave kombëtare në territoret e tyre përkatëse;

Duke pasur parasysh se ndryshimet në historinë e Evropës kanë treguar se rmbrojtja e pakicave kombëtare paraqet rëndësi për stabilitetin, sigurimin demokratik dhe paqen në këtë kontinent;

Duke konsideruar se një shoqëri pluraliste dhe e vërtetë demokratike duhet që jo vetëm të respektojë identitetin etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar të çdo personi që i përket një pakice kombëtare, por gjithashtu edhe të krijojë kushtet e nevojshme që iu japin mundësi atyre për të shprehur, ruajtur dhe-zhvilluar këtë identitet;

Duke pasur parasysh se krijimi i një klime të tolerancës dhe dialogut është e nevojshme që t'i mundësojë shumëllojshmërisë kulturore që të jetë një burim e faktor i pasurimit të çdo shoqërie, dhe jo i ndarjes;

Duke konsideruar se ndërtimi i një Evrope tolerante dhe të begatuar nuk varet vetëm në bashkëpunimin ndërmjet shteteve, por kërkon gjithashtu edhe bashkëpunimin ndërkufitar ndërmjet autoriteteve lokale dhe rajonale, pa cënuar kushtetutën dhe integritetin territorial të çdo shteti;

Duke pasur parasysh Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, dhe Protokollet e saj;

Duke iu referuar angazhimeve mbi mbrojtjen e pakicave kombëtare në konventat dhe deklaratat e Kombeve të Bashkuara, dhe në dokumentet e Konferencës mbi Sigurimin dhe Bashkëpunimin në Evropë, veçanërisht Dokumentin e Kopenhagenit, më 29 qershor 1990;

Të angazhuar për të përcaktuar parimet që duhen respektuar dhe detyrimet që burojnë prej tyre, me qëllim që të sigurojnë, në shtetet anëtare dhe shtetet të tjera që mund të bëhen palë në këtë instrument, mbrojtjen efektive të pakicave kombëtare dhe të të drejtave e lirive të personave që iu përkasin këtyre pakicave, në kuadrin e shtetit ligjor, respektimit të integritetit territorial dhe sovranitetit kombëtar të shteteve;

Të vendosur për të zbatuar parimet e parashtruara në këtë Konventë kuadër nëpërmjet legjislacionit kombëtar dhe politikave qeveritare të përshtatshme,

Bien dakord si vijon:

Pjesa I

Neni 1

Mbrojtja e pakicave kombëtare dhe e të drejtave e lirive të personave që iu përkasin këtyre pakicave formojnë një pjesë përbërëse të mbrojtjes ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, dhe si të tilla përfshihen në kuadrin e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Neni 2

Dispozitat e kësaj Konvente kuadër do të zbatohen në mirëbesim, në frymën e mirëkuptimit dhe tolerancës, dhe në përputhje me parimet e fqinjësisë së mirë, marrëdhënieve miqësore dhe bashkëpunimit ndërmjet shteteve.

Neni 3

- 1.Çdo person që i përket një pakice kombëtare do të ketë të drejtën që të zgjedhë lirisht për t'u trajtuar apo jo si i tillë, dhe nuk do të ketë asnjë disavantazh nga kjo zgjedhje apo nga ushtrimi i të drejtave që lidhen me këtë zgjedhje.
- 2.Personat që u përkasin pakicave kombëtare mund të ushtrojnë të drejtat dhe të gëzojnë liritë që burojnë prej parimeve të parashikuara në këtë Konventë kuadër në mënyrë individuale si dhe në bashkësi me të tjerët.

Pjesa II

Neni 4

- 1.Palët angazhohen t'iu garantojnë personave që iu përkasin pakicave kombëtare të drejtën e barazisë para ligjit dhe të mbrojtjes së barabartë nga ligji. Lidhur me këtë, do të ndalohet çdo diskriminim bazuar në përkatësinë në një pakicë kombëtare.
- 2.Palët angazhohen që të miratojnë, kurdoherë që është e nevojshme, masa të përshtatshme me qëllim që të nxisin, në të gjitha sferat e jetës ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore, barazi të plotë dhe efektive ndërmjet personave që i përkasin një pakice kombëtare dhe atyre që i përkasin shumicës. Lidhur me këtë, ata do të marrin parasysh në mënyrën e duhur kushtet e veçanta të personave që u përkasin pakicave kombëtare.
- 3.Masat e miratuara në përputhje me paragrafin 2 nuk do të konsiderohen se janë një akt diskriminimi.

Neni 5

- 1.Palët angazhohen të nxisin kushtet e nevojshme për personat që iu përkasin pakicave kombëtare për të ruajtur dhe zhvilluar kulturën e tyre, dhe për të ruajtur elementet themelore të këtij identiteti, konkretisht besimin fetar, gjuhën, traditat dhe trashëgiminë kulturore.
- 2.Pa cënuar masat e marra për realizimin e politikës së tyre të integritimit të përgjithshëm, Palët nuk do të ndërmarrin politika apo praktika që synojnë në asimilimin e personave që iu përkasin pakicave kombëtare kundër vullnetit të tyre dhe do të mbrojnë këta persona nga çdo akt që synon një asimilim i tillë.

Neni 6

1.Palët do të inkurajojnë një frymë tolerance dhe dialogun ndërkulturor dhe do të marrin masa efektive për të nxitur respektin e ndërsjellët, mirëkuptimin dhe bashkëpunimin ndërmjet të gjithë personave që jetojnë në territorin e tyre pa dallim përsa i përket identitetit etnik, kulturor, gjuhësor apo fetar të këtyre personave veçanërisht në fushën e arsimit, kulturës dhe shtypit.

2.Palët angazhohen të marrin masa të përshtatshme të mbrojnë personat që mund ti nënshtrohen kërcënimeve apo akteve të diskriminimit, armiqësisë apo dhunës, si pasojë e identitetit të tyre etnik, kulturor gjuhësor apo fetar.

Neni 7

Palët do të sigurojnë respektimin e së drejtës së çdo personi që i përket një pakice kombëtare për lirinë e grumbullimeve paqësore, lirinë e organizimit, lirinë e shprehjes dhe lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe besimit fetar.

Neni 8

Palët angazhohen të pranojnë se çdo person që i përket një pakice kombëtare ka të drejtën të manifestojë fenë apo besimin e tij/saj dhe të krijojë institucionet, organizatat dhe shoqatat fetare.

Neni 9

1.Palët angazhohen të pranojnë se e drejta e lirisë së shprehjes së çdo personi që i përket një pakice kombëtare përfshin lirinë për të pasur mendime, dhe për të marrë dhe shpërndarë informacione e ide në gjuhën e pakicës, pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pavarësisht nga kufijtë. Palët do të sigurojnë, brenda kuadrit të sistemeve të tyre ligjore, që personat që i përkasin një pakice kombëtare nuk diskriminohen lidhur me raportet e tyre me shtypin.

2.Paragrafi 1 nuk do të ndalojë Palët që të kërkojnë, pa diskriminim dhe mbi bazën e kritereve objektive, liçensimin e radiopërhapjes dhe televizionit, apo ndërmarrjeve të kinemasë.

3.Palët nuk do të pengojnë krijimin dhe përdorimin e shtypit të shkruar nga personat që i përkasin pakicave kombëtare. Në kuadrin ligjor të sistemit të përhapjes së radios dhe televizionit, ata do të sigurojnë, për aq sa është e mundur, dhe duke pasur parasysh dispozitat e paragrafit 1, që personat që i përkasin pakicave kombëtare t'u jepen mundësi për të pasur dhe përdorur shtypin e tyre.

4.Në kuadrin e sistemit të tyre ligjor, Palët do të miratojnë masa të përshtatshme për të lehtësuar kontaktet me shtypin për personat që i përkasin pakicave kombëtare dhe për të nxitur tolerancën dhe lejuar shumëllojshmërinë kulturore.

Neni 10

1.Palët angazhohen të njohin që çdo person që i përket një pakice kombëtare ka të drejtën të përdorë lirisht dhe pa ndërhyrje gjuhën e tij/saj të pakicës, në mënyrë personale dhe publike, me gojë dhe me shkrim.

2.Në zonat ku personat që i përkasin pakicave kombëtare banojnë tradicionalisht apo në numër thelbësor, në qoftë se këta persona parashtrojnë kërkesë, dhe kur ajo i përgjigjet një nevojë reale, Palët do të përpiqen të sigurojnë, për aq sa është e mundur, kushtet që

mund të bëjnë të mundur përdorimin e gjuhës së pakicës në marrëdhëniet ndërmjet këtyre personave dhe autoriteteve administrative.

3. Palët angazhohen të garantojnë të drejtën e çdo personi që i përket një pakice kombëtare për t'u informuar menjëherë, në një gjuhë që ai/ajo e kupton, mbi arsyet e arrestimit të tij/saj, dhe për natyrën dhe shkakun e çdo akuze kundër tij/saj, dhe për të mbrojtur veten e tij/saj në këtë gjuhë, dhe në se është e nevojshme me ndihmën pa pagesë të një përkthyesi.

Neni 11

1. Palët angazhohen të njohin se çdo person që i përket pakicave kombëtare ka të drejtën të përdorë mbiemrin (prejardhjen) dhe emrat e parë në gjuhën e pakicës dhe të drejtën për njohjen e tyre zyrtarisht, në përputhje me procedurat e parashikuara në sistemin e tyre ligjor.

2. Palët angazhohen të njohin se çdo person që i përket një pakice kombëtare ka të drejtën të shfaqë në gjuhën e tij/saj të pakicës shenja, mbishkrime dhe informacione të tjera të një natyre personale në mënyrë të dukshme për publikun.

3. Në zonat e banuara tradicionalisht nga një numër thelbësor i personave të pakicave kombëtare, Palët do të përpiqen, në kuadrin e sistemit të tyre ligjor, përfshirë kur është e përshtatshme, marrëveshje me shtetet e tjera, dhe duke marrë parasysh kushtet e tyre të veçanta, të vendosin emrat tradicionalë vendas, emrat e rrugëve dhe tregues të tjerë topografikë për publikun edhe në gjuhën e pakicës, kur ka një kërkesë të mjaftueshme për këta tregues.

Neni 12

1. Palët, kur është e përshtatshme, do të marrin masa në fushën e arsimit dhe studimeve për të nxitur njohjen e kulturës, historisë, gjuhës dhe besimit fetar të pakicave kombëtare të tyre dhe të shumicës.

2. Në këtë kuadër, Palët do të sigurojnë ndër të tjera mundësi të përshtatshme për kualifikimin e mësuesve dhe pajisjen me tekste shkollore, dhe të lehtësojnë kontaktet ndërmjet studentëve dhe mësuesve të komuniteteve të ndryshme.

3. Palët angazhohen të nxisin mundësi të barabarta për ndjekjen e arsimit në të gjitha nivelet për personat që i përkasin pakicave kombëtare.

Neni 13

1. Në kuadrin e sistemeve të tyre arsimore, Palët do të njohin se personat që i përkasin një pakice kombëtare kanë të drejtë të ndërtojnë dhe drejtojnë institucionet e tyre arsimore dhe kualifikuese private.

2. Ushtrimi i kësaj të drejte nuk do të sjellë ndonjë detyrim financiar për Palët.

Neni 14

1. Palët angazhohen të njohin se çdo person që i përket një pakice kombëtare ka të drejtën të mësojë gjuhën e tij/saj të pakicës.

2. Në zonat ku personat që i përkasin pakicave kombëtare banojnë tradicionalisht apo në numër thelbësor, në se ka një kërkesë të mjaftueshme, Palët do të përpiqen të sigurojnë, për aq sa është e mundur, dhe në kuadrin e sistemeve të tyre arsimore, që personat që i përkasin këtyre pakicave të kenë mundësi të përshtatshme për të mësuar gjuhën e pakicës

apo për të marrë mësim në këtë gjuhë.

3.Paragrafi 2 i këtij neni do të zbatohet pa cënuar mësimin e gjuhës zyrtare apo mësimin në këtë gjuhë.

Neni 15

Palët do të krijojnë kushtet e nevojshme për pjesëmarrjen aktive të personave që i përkasin pakicave kombëtare në jetën kulturore, shoqërore dhe ekonomike dhe në çështjet publike, veçanërisht për ato që ndikojnë mbi ta.

Neni 16

Palët nuk do të ndërmarrin masa që ndryshojnë përbërjen e popullsisë në zonat e banuara nga personat që u përkasin pakicave kombëtare dhe synojnë në kufizimin e të drejtave e lirive që burojnë nga parimet e parashikuara në këtë Konventë kuadër.

Neni 17

1.Palët angazhohen të mos ndërhyjnë në të drejtën e personave që i përkasin pakicave kombëtare për të vendosur dhe mbajtur kontakte të lira dhe paqësore përgjatë kufijve me personat që banojnë ligjërisht në shtete të tjera, veçanërisht me ata me të cilat kanë një identitet etnik, kulturor, gjuhësor apo fetar, apo një trashëgimi të përbashkët kulturore.

2.Palët angazhohen të mos ndërhyjnë në të drejtën e personave që i përkasin pakicave kombëtare për të marrë pjesë në aktivitetet e organizatave jo-qeveritare, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Neni 18

1.Palët do të përpiqen të përfundojnë, kur është e nevojshme, marrëveshje dypalëshe dhe shumëpalëshe me shtetet e tjera, veçanërisht me shtetet fqinje, për të siguruar mbrojtjen e personave që i përkasin pakicave kombëtare përkatëse.

2. Kur është me vend, Palët do të marrin masa për të inkurajuar bashkëpunimin ndërkufitar.

Neni 19

Palët angazhohen të respektojnë dhe zbatojnë parimet e parashikuara në këtë Konventë kuadër, duke bërë, kur është e nevojshme, vetëm ato kufizime apo shmangie që janë parashikuar në instrumentet juridike ndërkombëtare, veçanërisht në Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, në masën që ato janë të përshtatshme për të drejtat dhe liritë që burojnë nga këto parime.

Pjesa III

Neni 20

Në ushtrimin e të drejtave dhe lirive që burojnë nga parimet e parashikuara në këtë Konventë kuadër, çdo person që i përket një pakice kombëtare do të respektojë legjislacionin kombëtar dhe të drejtat e të tjerëve, veçanërisht atyre të personave që i përkasin shumicës apo pakicave të tjera kombëtare.

Neni 21

Asgjë në këtë Konventë kuadër nuk do të interpretohet se nënkupton ndonjë të drejtë për t'u angazhuar në aktivitete apo për të kryer ndonjë veprim kundër parimeve themelore të së drejtës ndërkombëtare, dhe veçanërisht barazisë sovrane, integritetit territorial dhe pavarësisë politike të shteteve.

Neni 22

Asgjë në këtë Konventë kuadër nuk do të kuptohet se kufizon apo shmang ndonjë prej të drejtave të njeriut dhe lirive themelore që mund të sigurohen sipas ligjeve të ndonjë Pale Kontraktuese, apo sipas ndonjë marrëveshje tjetër ku ajo është Palë.

Neni 23

Të drejtat dhe liritë që burojnë nga parimet e parashikuara në këtë Konventë kuadër, në masën që ato janë objekt i një dispozite përgjegjëse në Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore apo në Protokollin e saj, do të kuptohen në një mënyrë që vjen në përputhje me dispozitat e kësaj të fundit.

Pjesa IV

Neni 24

1. Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës do të mbikqyrë zbatimin e kësaj Konvente kuadër nga Palët Kontraktuese.
2. Palët që nuk janë anëtare të Këshillit të Evropës do të marrin pjesë në mekanizmin zbatues, sipas procedurave që do të përcaktohen.

Neni 25

1. Brenda një periudhe 1 vjeçare pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente kuadër lidhur me një Palë Kontraktuese, kjo e fundit do t'i transmetojë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës informacion të plotë mbi masat legjislative dhe të tjera, të marra për zbatimin e parimeve të parashtruara në këtë Konventë kuadër.
2. Për periudhën më pas, secila Palë do t'i transmetojë Sekretarit të Përgjithshëm, në

një mënyrë periodike dhe kurdoherë që kërkon Komiteti i Ministrave, çdo informacion shtesë përkatës lidhur me zbatimin e kësaj Konvente kuadër.

3. Sekretari i Përgjithshëm do t'i parashtojë Komitetit të Ministrave informacionin e transmetuar sipas kushteve të këtij Neni.

Neni 26

1. Në vlerësimin e përshtatshmërisë së masave të marra nga Palët për të zbatuar parimet e parashtruara në këtë Konventë kuadër, Komiteti i Ministrave do të ndihmohet nga një komitet këshillimor, anëtarët e të cilit do të kenë një kualifikim të njohur në fushën e mbrojtjes së pakicave kombëtare.
2. Përbërja e këtij komiteti këshillimor dhe procedurat e tij do të përcaktohen nga Komiteti i Ministrave brenda një periudhe 1 vjeçare pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente kuadër.

Pjesa V

Neni 27

Kjo Konventë kuadër do të hapet për nënshkrim nga shtetet anëtare të Këshillit të Evropës. Deri në datën kur Konventa hyn në fuqi, ajo do të jetë e hapur gjithashtu për nënshkrim edhe nga ndonjë shtet tjetër i ftuar nga Komiteti i Ministrave. Ajo i nënshtrohet ratifikimit, pranimit apo miratimit. Instrumentet e ratifikimit, pranimit apo miratimit do të depozitohen tek Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës.

Neni 28

1.Kjo Konventë kuadër do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit pasues pas periudhës 3-mujore pas datës në të cilën 12 shtete anëtare të Këshillit të Evropës kanë shprehur pëlqimin e tyre për të pranuar si të detyrueshme Konventën, në përputhje me dispozitat e Nenit 27.

2.Lidhur me secilin shtet anëtar, i cili shpreh më pas pëlqimin e tij për të pranuar si të detyrueshme atë, Konventa kuadër do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit pasues pas periudhës 3- mujore pas datës së depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit apo miratimit.

Neni 29

1.Pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente kuadër dhe pas konsultimit të Shteteve Kontraktuese, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës mund të ftojë për të aderuar në Konventë, nëpërmjet një vendimi të marrë me shumicën e parashikuar në Nenin 20.d të Statutit të Këshillit të Evropës, çdo shtet jo-anëtar të Këshillit të Evropës, që i ftuar të nënshkruajë në përputhje me dispozitat e Nenit 27, nuk e ka bërë këtë akoma, dhe çdo shtet tjetër jo-anëtar.

2.Lidhur me ndonjë shtet aderues, i cili shpreh më pas pëlqimin e tij për të pranuar si të detyrueshme atë, Konventa kuadër do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit pasues pas periudhës 3- mujore pas datës së depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit apo miratimit.

Neni 30

1.Secili shtet mund të përcaktojë, në kohën e nënshkrimit, apo kur depoziton instrumentin e tij të ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit, territorin apo territoret për të cilat ai është përgjegjës në marrëdhëniet ndërkombëtare ku do të zbatohet kjo Konventë kuadër.

2.Secili shtet mund të zgjerojë, në një kohë të mëvonshme, me anë të një deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, zbatimin e kësaj Konvente kuadër në çdo territor tjetër të përcaktuar në deklaratë. Lidhur me këto territore, Konventa kuadër do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit pasues pas përfundimit të periudhës 3-mujore pas datës së marrjes së një deklaratë të tillë nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Çdo deklaratë e bërë sipas dy paragrafeve të mësipërm mund të tërhiqet, lidhur me çdo territor të përcaktuar në këtë deklaratë, me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të përgjithshëm. Tërheqja do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit pasues pas përfundimit të periudhës 3-mujore pas datës së marrjes të një njoftimi të tillë nga Sekretari i

Përgjithshëm.

Neni 31

1. Secila Palë mund të denoncojë në çdo moment këtë Konventë kuadër nëpërmjet një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.
2. Ky denoncim do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit pasues pas përfundimit të një periudhe 6-mujore pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 32

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës do të njoftojë shtetet anëtare të Këshillit, shtetet e tjera nënshkruese dhe çdo shtet që ka aderuar në këtë Konventë kuadër për:

- a. çdo nënshkrim;
- b. depozitim të secilit instrument të ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit;
- c. secilën datë të hyrjes në fuqi të kësaj Konvente kuadër në përputhje me Nenin 28, 29 dhe 30;
- d. secilin veprim, njoftim apo komunikim tjetër lidhur me këtë Konventë kuadër.

Në prani të nënshkruesve, të autorizuar në mënyrën e duhur, kanë nënshkruar këtë Konventë kuadër.

Bërë në ... ditën e ..., në gjuhën angleze dhe franceze, duke pasur të dy tekstet të njëjtën vlerë, në një kopje të vetme, e cila do të depozitohet në arkivat e Këshillit të Evropës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës do t'i transmetojë kopjet e vërtetuara secilit shtet anëtar të Këshillit të Evropës dhe secilit shtet të ftuar për të nënshkruar apo aderuar në këtë Konventë kuadër.

RAPORTI SHPJEGUES MBI KONVENTËN KUADËR PËR MBROJTJEN E PAKICAVE KOMBËTARE

Historik

1. Këshilli i Evropës ka shqyrtuar situatën e pakicave kombëtare në një numër rastesh gjatë një periudhe prej më shumë se 40 vjetësh. Pothuajse që vitin e parë të krijimit të saj (1949), Asambleja Parlamentare njohu, në një raport të Komitetit mbi Çështjet Ligjore dhe Administrative, rëndësinë e "problemit të mbrojtjes më të gjerë të të drejtave të pakicave kombëtare". Në vitin 1961, Asambleja rekomandoi përfshirjen e një neni në një protokoll të dytë shtesë për t'iu garantuar pakicave kombëtare një sërë të drejtash, që nuk përfshihen nga Konventa Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Kjo e fundit i referohet thjesht "bashkimit me një pakicë kombëtare" në dispozitën e mos-diskriminimit të parashikuar në Nenin 14. Rekomandimi 285 (1961) propozonte formulimin e mëposhtëm për projekt nenin mbi mbrojtjen e pakicave

kombëtare:

"Personave që i përkasin një pakice kombëtare nuk do t'i mohohen e drejta, në bashkësi me

anëtarët e tjerë të grupit të tyre etnik, dhe në masën që është në përputhje me rendin publik,

të gëzojnë kulturën e tyre, të përdorin gjuhën e tyre, të krijojnë shkollat e tyre dhe të mësojnë në gjuhën e zgjedhur prej tyre apo të ushtrojnë e praktikojnë besimin e tyre fetar".

2. Komiteti i Ekspertëve, që ishte udhëzuar për të shqyrtuar nëse ishte e mundur dhe e këshillueshme për të hartuar një protokoll të tillë, i shtyu aktivitetet e tij deri sa të arrihej në një vendim përfundimtar mbi rastet gjuhësore në Belgjikë lidhur me gjuhën e përdorur në arsim (Eur. Court H.R. Judgment 27 qershor 1968, Seria A, Nr 6). Në vitin 1973 ai arriti në përfundimin se nga pikëpamja ligjore nuk ekziston një nevojë e veçantë për t'i bërë objekt të ndonjë protokollit shtesë të KEDNJ të drejtat e pakicave. Megjithatë, ekspertët menduan se nuk ka pengesa juridike kryesore për miratimin e një protokollit të tillë, në qoftë se gjykohej e këshillueshme për arsye të tjera.

3. Kohët e fundit, Asambleja Parlamentare i rekomandoi Komitetit të Ministrave një numër masash politike dhe ligjore, në mënyrë të veçantë për të hartuar një protokoll apo konvente mbi të drejtat e pakicave kombëtare. Rekomandimi 1134 (1990) përmban një listë parimesh, të cilat Asambleja i konsideroi të nevojshme për mbrojtjen e pakicave kombëtare. Në tetor 1991, Komitetit Drejtues për të Drejtat e Njeriut (KDDNJ) iu ngarkua detyra për të shqyrtuar, si nga pikëpamja ligjore dhe politike, kushtet në të cilat Këshilli i Evropës mund të ndërmerre një aktivitet për mbrojtjen e pakicave kombëtare, duke pasur parasysh punën e bërë nga Konferenca mbi Sigurimin dhe Bashkëpunimin në Evropë (KSBE) dhe Kombet e Bashkuara, si dhe përfundimet brenda Këshillit të Evropës.

4. Në maj 1992, Komiteti i Ministrave udhëzoi KDDNJ të shqyrtojë mundësinë e formulimit të standarteve ligjore të veçanta lidhur me mbrojtjen e pakicave kombëtare. Për këtë qëllim, KDDNJ krijoi një komitet ekspertësh (DH-MIN), të cilit, sipas mandatit të ri të dhënë në mars 1993, iu kërkua të propozonte standarte ligjore të veçanta në këtë fushë, duke pasur parasysh parimin e koordinimit dhe plotësimin të punës ndërmjet Këshillit të Evropës dhe KSBE. KDDNJ dhe DH-MIN morën parasysh tekste të ndryshme, në veçanti propozimin për një Konventë Evropiane për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare të hartuar nga Komisioni Evropian për Demokracinë nëpërmjet Ligjit (i quajtur Komisioni i Venecias), propozimin austriak për një protokoll shtesë në KEDNJ, projekt protokollin shtesë në KEDNJ të përfshirë në Rekomandimin e Asamblesë 1201 (1993) dhe propozime të tjera. Ky shqyrtim arriti pikën kulmore në raportin që KDDNJ i paraqiti Komitetit të Ministrave në 8 shtator 1993, që përfshiu standarte të ndryshme ligjore që mund të miratoheshin në këtë fushë dhe instrumentet ligjore ku mund të parashtraheshin ato. Lidhur me këte, KDDNJ konstatoi se nuk ekzistonte një mendim i përbashkët mbi interpretimin e termit "pakica kombëtare".

5. Hapi vendimtar u ndërmor në momentin kur Kryetarët e Shtetit dhe Qeverisë të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës u takuan në Vjenë, në Takimin e Nivelit të Lartë, më 8-9 tetor 1993. Këtu u ra dakord që pakicat kombëtare, të cilat ishin krijuar si rezultat i zhvillimeve historike në Evropë, duhet të mbroheshin dhe respektoheshin si një kontribut për paqen dhe stabilitetin. Në mënyrë të veçantë, Kryetarët e Shtetit dhe

Qeverisë vendosën të marrin përsipër angazhime ligjore lidhur me mbrojtjen e pakicave kombëtare. Shtojca II e Deklaratës së Vjenës udhëzoi Komitetin e Ministrave:

- të hartonte pa vonesë një konventë kuadër që përcaktonte parimet ndaj të cilave shtetet palë angazhohen për të respektuar, me qëllim që të sigurojnë mbrojtjen e pakicave kombëtare. Ky instrument do të ishte i hapur për nënshkrim edhe për shtetet jo-anëtare;
- të fillonte puna për hartimin e një protokollit plotësues të Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut në fushën kulturore, me dispozita që garantonin të drejtat individuale, në veçanti për personat që i përkasin pakicave kombëtare.

6. Më 4 nëntor 1993, Komiteti i Ministrave krijoi një Komitet ad hoc për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (CAHMIN). Mandati i tij pasqyrore vendimet e marra në Vjenë. Komiteti, i përbërë prej ekspertëve nga shtetet ~nëtare në Këshillin e Evropës, filloi punën në fund të janarit 1994, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të KDDNJ, Këshillit për Bashkëpunimin Kulturor (KBK), Komitetit Drejtues mbi Shtypin (KDSH) dhe Komisionit Evropian për Demokracinë nëpërmjet Ligjit. Komisioneri i Lartë i KSBE-së për Pakicat Kombëtare dhe Komisioni i Komuniteteve Evropiane morën pjesë gjithashtu si vëzhgues.

7. Më 15 prill 1994, CAHMIN i parashtrori Komitetit të Ministrave një raport të ndërmjetëm, i cili më pas iu komunikua Asamblesë Parlamentare (Dok. 7109). Komiteti i Ministrave, në sesionin e 94 të tij, në maj 1994, shprehu kënaqësinë për përparimin e arritur sipas mandatit të dhënë në Deklaratën e Vjenës.

8. Një numër dispozitash të Konventës kuadër që kërkojnë arbitrimin politik, si dhe ato lidhur me mbikqyrjen e zbatimit, u hartuan nga Komiteti i Ministrave (takimi 517bis i Zëvendësministrave, 7 tetor 1994).

9. Në takimin e tij të datës 10-14 tetor 1994, CAHMIN vendosi t'i parashtrrojë projekt Konventën kuadër Komitetit të Ministrave, i cili miratoi tekstin në sesionin ministerial më 10 nëntor 1994. Konventa kuadër u hap për nënshkrim nga shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, me .. .

Vlerësime të përgjithshme

Objektivat e Konventës kuadër

10. Konventa kuadër është instrumenti i parë shumëpalësh me karakter të detyrueshëm ligjor, kushtuar mbrojtjes së pakicave kombëtare në përgjithësi. Ajo ka për qëllim të përcaktojë parimet ligjore ndaj të cilave shtetet angazhohen t'i respektojnë për të siguruar mbrojtjen e pakicave kombëtare. Me anë të saj, Këshilli i Evropës realizoi thirrjen e Deklaratës së Vjenës (Shtojca II) për të transformuar angazhimet politike të miratuara nga Konferenca për Sigurimin dhe Bashkëpunimin në Evropë (KSBE), në masën më të madhe të mundshme, në detyrime ligjore.

Mënyrat e trajtimit dhe konceptet themelore

11. Përballë sferës së situatave dhe problemeve të ndryshme që duhen zgjidhur, prioriteti u përcaktua për një Konventë kuadër, e cila përmban kryesisht dispozita të tipit programor,

që parashtron objektivat për ndjekjen e të cilave angazhohen Palët. Këto dispozita, që nuk do të jenë të zbatueshme drejtpërsëdrejti, iu lënë shteteve të interesuara një shkallë, gjykimi në zbatimin e objektivave për arritjen e të cilave angazhohen ata, duke iu dhënë kështu mundësinë atyre që të marrin parasysh rrethanat e veçanta.

12. Gjithashtu, duhet të theksohet se Konventa kuadër nuk përmban përkufizimin e termit "pakicë kombëtare". Duke u bazuar në pohimin se në këtë fazë është e pamundur që të

arrihet në një përkufizim që mund të fitojë përkrahjen e përgjithshme të të gjithë shteteve anëtare në Këshillin e Evropës, u vendos që të ndiqet një trajtim pragmatik.

13. Zbatimi i parimeve të parashtruara në këtë Konventë kuadër do të realizohet nëpërmjet legjisllacionit kombëtar dhe politikave qeveritare të përshtatshme. Ajo nuk nënkupton njohjen e të drejtave kolektive. Theksi është vënë në mbrojtjen e personave që i përkasin pakicave kombëtare, që mund të ushtrojnë të drejtat e tyre në mënyrë individuale dhe në bashkësi me të tjerët (shih Nenin 3, paragrafi 2). Në këtë aspekt, Konventa kuadër ka të njëjtën mënyrë trajtimi si ato të teksteve të miratuara nga organizatat e tjera ndërkombëtare.

Struktura e Konventës kuadër

14. Krahas parathënies së saj, Konventa kuadër përmban një pjesë vepruese, e cila ndahet në pesë kapituj.

15. Kapitulli I përmban dispozita që, në mënyrë të përgjithshme parashtrojnë një sërë parimesh të përgjithshme që mund të shërbejnë për të bërë të qarta dispozitat e tjera themelore të Konventës kuadër.

16. Kapitulli II përmban një listë të parimeve të veçanta.

17. Kapitulli III përmban dispozita të ndryshme lidhur me interpretimin dhe zbatimin e Konventës kuadër.

18. Kapitulli IV përmban dispozita mbi mbikqyrjen e zbatimit të Konventës kuadër.

19. Kapitulli V përmban dispozita përfundimtare, të cilat mbështeten në nenet përfundimtare model për konventat dhe marrëveshjet, të përfunduara në Këshillin e Evropës.

Komentat mbi dispozitat e Konventës Kuadër

Parathënie

20. Parathënia parashtron arsyet për hartimin e kësaj Konvente kuadër dhe shpjegon një sërë interesash themelore të hartuesve të saj. Fjalët hyrëse tregojnë se ky instrument mund të nënshkruhet dhe ratifikohet nga shtetet jo-anëtare të Këshillit të Evropës (shih Nenin 27).

21. Parathënia i referohet qëllimit programativ të Këshillit të Evropës dhe një prej metodave për arritjen e këtij qëllimi: ruajtjen dhe realizimin e mëtejshëm të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore.

22. Gjithashtu, i referohet edhe Deklaratës së Vjenës të Kryetarëve të Shtetit dhe Qeverisë të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës, një dokument që hodhi themelet për këtë Konventë kuadër (shih gjithashtu paragrafin 5 më sipër). Në fakt, teksti i parathënies është frymëzuar gjerësisht nga kjo Deklaratë, në veçanti Shtojca II e saj. Po kështu, kjo është e vërtetë edhe për angazhimet e përfshira në Kapitujt I dhe II të Konventës kuadër.

23. Parathënia përmend, jo në mënyrë tërësore, tre burime të tjera që kanë frymëzuar përmbajtjen e Konventës kuadër: Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNJ) dhe instrumentet e OKB-së dhe KSBE-së që përmbajnë angazhime lidhur me mbrojtjen e pakicave kombëtare.

24. Parathënia pasqyron shqetësimin e Këshillit të Evropës dhe shteteve anëtare të tij mbi rrezikun për ekzistencën e pakicave kombëtare dhe është frymëzuar nga Neni 1, paragrafi 1 të Deklaratës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Personave që iu përkasin Pakicave Kombëtare apo Etnike, Fetare dhe Gjuhësore {Rezoluta 47/135 e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme më 18 dhjetor 1992).

25. Duke pasur parasysh faktin se Konventa kuadër është e hapur gjithashtu edhe për

shtetet që nuk janë anëtare të Këshillit të Evropës, dhe për të siguruar një trajtim më tërësor është vendosur të përfshihen një sërë parimesh prej të cilave burojnë të drejtat dhe liritë që janë garantuar tashmë në KBDNJ apo në protokollin e saj (lidhur me këtë, shih edhe Nenin 23 të Konventës kuadër).

26. Referimi në Konventat dhe deklaratat e Kombeve të Bashkuara rikujton punën e bërë në nivel universal, për shembull, në Konventën mbi të Drejtat Civile dhe Politike (Neni 27) dhe në Deklaratën mbi të Drejtat e Personave që iu përkasin Pakicave Kombëtare apo Etnike, Fetare dhe Gjuhësore. Megjithatë, ky referim nuk përfshin ndonjë përkufizim të një pakice kombëtare, që mund të përmbajnë këto tekste.

27. Referimi në angazhimet përkatëse të KSBE-së pasqyron dëshirën e shprehur në Shtojcën II të Deklaratës së Vjenës, se Këshilli i Evropës, duhet të punojë për të transformuar, në masën më të madhe të mundshme këto angazhime politike në detyrime ligjore. Në veçanti, Dokumenti i Kopenhagenit siguroi orientimin për hartimin e Konventës kuadër.

28. Paragrafi i fundit në parathënie parashtron qëllimin kryesor të Konventës kuadër të sigurojë mbrojtje efektive të pakicave kombëtare dhe të të drejtave të personave që iu përkasin këtyre pakicave. Gjithashtu, ajo thekson se mbrojtja efektive duhet të sigurohet në kuadrin e shtetit ligjor, respektimit të integritetit territorial dhe sovranitetit kombëtar të shteteve.

29. Qëllimi i parashtrimit të fundit është të tregojë se dispozitat e kësaj Konvente kuadër nuk zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë Ajo nuk angazhohet me legjislacionin dhe praktikën e Palëve për zbatimin e traktateve ndërkombëtare në rendin e brendshëm ligjor.

Kapitulli I

Neni 1

30. Neni 1 ka për qëllim kryesor të përcaktojë se mbrojtja e pakicave kombëtare, e cila formon një pjesë përbërëse të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, nuk përbën një çështje të kompetencës së rezervuar për shtetet. Deklarimi se kjo mbrojtje formon një pjesë përbërëse të mbrojtjes ndërkombëtare të të drejtave të njeriut nuk iu njeh organeve të përcaktuara nga KBDNJ ndonjë kompetencë për të interpretuar këtë Konventë kuadër.

31. Neni i referohet mbrojtjes së pakicave kombëtare si të tilla, dhe të drejtave e lirive të personave që iu përkasin këtyre pakicave. Ky dallim dhe ndryshim në formulim bënë të qartë se nuk parashikohen të drejta kolektive të pakicave kombëtare (shih edhe komentimin e Nenit 3). Megjithatë, Palët njohin se mbrojtja e një pakice kombëtare mund të arrihet nëpërmjet mbrojtjes së të drejtave të individëve që i përkasin një pakice të tillë.

Neni 2

32. Ky nen përmban një tërësi parimesh që rregullojnë zbatimin e Konventës kuadër. Ndër të tjera, ai është bazuar në Deklaratën e Kombeve të Bashkuara mbi Parimet e së Drejtës Ndërkombëtare lidhur me Marrëdhëniet Miqësore dhe Bashkëpunimin ndërmjet Shteteve në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara (Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 2625 (XXV), të datës 24 tetor 1970). Parimet e përmendura në këtë dispozitë janë të një natyre të përgjithshme, por gjithashtu lidhen edhe në mënyrë të veçantë me fushën e trajtuar nga Konventa kuadër.

Neni 3

33. Ky nen përmban dy parime të veçanta, por të ndërvarura, të parashtruara në dy paragrafe të ndryshëm.

Paragrafi 1

34. Paragrafi 1 i garanton së pari çdo personi që i përket një pakice kombëtare lirinë që të zgjedhin për t'u trajtuar apo jo si të tillë. Kjo dispozitë ia lë këtë çdo personi të tillë për të vendosur nëse dëshiron apo jo që të vendoset nën mbrojtjen që sigurojnë parimet e Konventës kuadër.

35. Ky paragraf nuk nënkupton thjesht një të drejtë për një individ që të zgjedhë arbitrarisht që t'i përkasë një pakice kombëtare. Zgjedhja subjektive individuale është pandashmërisht e lidhur me kriterin objektiv përkatës të identitetit të personit.

36. Paragrafi 1 garanton më tej se nuk do të ketë asnjë disavantazh nga zgjedhja e lirë për atë që ajo garanton, apo nga ushtrimi i të drejtave që janë të lidhura me këtë zgjedhje. Kjo pjesë e dispozitës synon të sigurojë që gëzimi i lirisë për të zgjedhur nuk do të çenohet në mënyrë jo të drejtpërdrejtë.

Paragrafi 2

37. Paragrafi 2 garanton se të drejtat dhe liritë që burojnë nga parimet e Konventës kuadër mund të ushtrohen në mënyrë individuale apo në bashkësi me të tjerët. Në këtë mënyrë, ajo njeh mundësinë e ushtrimit të përbashkët të këtyre të drejtave dhe lirive, ç'ka është krejt e veçantë nga nocioni i të drejtave kolektive. Termi "të tjera" do të kuptohet në sensin më të gjerë të mundshëm dhe do të përfshijë personat që i përkasin të njëjtës pakice kombëtare, një pakice kombëtare tjetër, apo shumicës.

PJESA II

Neni 4

38. Qëllimi i këtij neni është sigurimi i zbatimit të parimeve të barazisë dhe mos-diskriminimit për personat që i përkasin pakicave kombëtare. Dispozitat e këtij neni duhet të kuptohen në kuadrin e kësaj Konvente kuadër.

Paragrafet 1 dhe 2

39. Paragrafi 1 adopton trajtimin klasik ndaj këtyre parimeve. Paragrafi 2 thekson se nxitja e barazisë së plotë dhe efektive ndërmjet personave që i përkasin një pakice kombëtare dhe atyre që i përkasin shumicës mund t'u kërkojnë Palëvë të miratojnë masa të veçanta që marrin parasysh kushtet e veçanta të personave të interesuar. Është e nevojshme që këto masa të "pershtaten", dmth, në përputhje me parimin e proporcionalitetit, me qëllim që të shmangen cënimi i të drejtave të të tjerëve si edhe diskriminimi kundër të tjerëve. Ky parim kërkon, ndërmjet të tjerash, që këto masa të mos shtrihen, në kohë dhe në hapësirë, tej kufirit të nevojshëm, në mënyrë që të arrijnë qëllimin e barazisë së plotë dhe efektive.

40. Në Konventën kuadër nuk është përfshirë ndonjë dispozitë e veçantë që trajton në mënyrë specifike parimin e mundësive të barabarta. Kjo përfshirje u konsiderua e nevojshme, pasi ky parim është zbatuar pothuajse në paragrafin 2 të këtij neni. Duke pasur parasysh parimin e mosdiskriminimit të parashtruar në paragrafin 1, e njëjta gjë është konsideruar e vërtetë edhe për lirinë e lëvizjes.

Paragrafi 3

41. Paragrafi 3 synon të bëjë të qartë se masat e përmendura në paragrafin 2 nuk duhen konsideruar se vijnë në kundërshtim me parimin e barazisë dhe të mosdiskriminimit.

Ai synon t'u sigurojë personave që i përkasin pakicave kombëtare barazi efektive krahas me personat që i përkasin shumicës.

Neni 5

42. Ky nen ka për synim themelor të sigurojë se personat që i përkasin pakicave

kombëtare mund të ruajnë dhe të zhvillojnë kulturën e tyre dhe mbrojnë identitetin e tyre.

Paragrafi 1

43. Paragrafi 1 përmban një detyrim për të nxitur kushtet e nevojshme në këtë drejtim. Ai përmend katër elemente themelore të identitetit të një pakice kombëtare. Kjo dispozitë nuk nënkupton se të gjitha ndryshimet etnike, kulturore, gjuhësore apo fetare çojnë domosdoshmërisht në krijimin e pakicave kombëtare (shih në këtë drejtim raportin e takimit të ekspertëve të KSBE-së, mbajtur në Gjenevë, në 1991, pjesa II, paragrafi 4)

44. Referimi në traditat" nuk është një përkrahje apo pranim i praktikave që janë ndesh legjislacionit kombëtar apo standarteve ndërkombëtare. Praktikrat tradicionale i nënshtrohen kufizimeve që rrjedhin prej kërkesave të rendit publik.

Paragrafi 2

45. Qëllimi i paragrafit 2 është mbrojtja e personave që u përkasin pakicave kombëtare nga asimilimi kundër vullnetit të tyre . Ai nuk pengon asimilimin vullnetar.

46. Paragrafi 2 nuk i pengon Palët nga ndërmarrja e angazhimeve për arritjen e politikës së përgjithshme të integritimit . Në këtë mënyrë, ajo njezh rëndësinë e kohezionit shoqëror dhe pasqyron dëshirën e shprehur në parathënie se shumëllojshmëria kulturore është një burim dhe faktor i pasurimit të çdo shoqërie, dhe jo i ndarjes.

Neni 6

47. Ky nen është një shprehje e shqetësimeve të deklaruara në Shtojcën III të Deklaratës së Vjenës (Deklarata dhe Plani i Veprimit mbi luftën kundër racizmit, ksenofobisë, antisemitizmit dhe intolerancës).

Paragrafi 1

48. Paragrafi 1 thekson një frymë tolerance dhe dialogu ndërkulturor, dhe evidenton rëndësinë e nxitjes prej Palëve të respektit, mirëkuptimit dhe bashkëpunimit të ndërsjellë ndërmjet të gjithë atyre që jetojnë në territorin e tyre. Fushat e arsimit, kulturës dhe shtypit janë përmendur në mënyrë të veçantë, sepse ato konsiderohen tepër të përshtatshme për arritjen e këtyre qëllimeve

49. Në funksion të forcimit të kohezionit shoqëror, ky paragraf synon, ndër të tjera, nxitjen e tolerancës dhe dialogut ndërkulturor, duke eliminuar pengesat ndërmjet personave që i përkasin grupeve etnike, kulturore, gjuhësore dhe fetare, nëpërmjet inkurajimit të organizatave dhe lëvizjeve ndërkulturore, të cilat kërkojnë nxitjen e respektit dhe mirëkuptimit të ndërsjellë dhe të integrojnë këta persona në shoqëri, ndërsa ruajnë identitetin e tyre.

Paragrafi 2

50. Kjo dispozitë bazohet në paragrafin 40.2 të Dokumentit të Kopenhagenit të KSBE-së. Ky detyrim synon në mbrojtjen e të gjithë personave që mund t'i nënshtrohen kërcënimeve apo veprimeve të diskriminimit, armiqësisë apo dhunës, pavarësisht nga vijnë këto kërcënime apo veprime.

Neni 7

51. Qëllimi i këtij neni është garantimi i respektit për të drejtën e çdo personi që i përket një pakice kombëtare për liritë themelore të përmendura këtu. Natyrisht, këto liri janë të një natyre universale, dmth, ato zbatohen për të gjithë personat, në se i përkasin apo jo një pakice kombëtare (për shembull, shih dispozitat përgjegjëse në nenet 9, 10 dhe 11 të KEDNJ), por ato janë veçanërisht të përshtatshme për mbrojtjen e pakicave kombëtare. Për arsyet e përmendura në komentin mbi parathënien, u vendos të përfshihen një sërë angazhimesh që janë edhe në KEDNJ.

52. Kjo dispozitë mund të nënkuptojë për Palët një sërë detyrimesh pozitive për të mbrojtur liritë e përmendura kundër shkeljeve që nuk e kanë burimin tek veprimtaria e shtetit. Sipas KEDNJ, mundësia e këtyre detyrimeve pozitive është njohur nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

53. Disa prej lirive të parashtruara në Nenin 7 janë shtjelluar në Nenet 8 e 9.

Neni 8

54. Ky nen parashtron rregulla më të hollësishme se Neni 7 për mbrojtjen e lirisë së besimit fetar. Ai kombinon në një dispozitë të vetme një sërë elementesh nga paragrafët 32.2, 32.3 dhe 32.6 të Dokumentit të Kopenhagenit të KSBE-së. Natyrisht, që kjo liri zbatohet për të gjithë personat dhe personat që i përkasin një pakice kombëtare, në përputhje me Nenin 4, duhet ta gëzojnë atë. Duke pasur parasysh rëndësinë e kësaj lirie në kuadrin aktual, u gjykua veçanërisht e përshtatshme që asaj t'i kushtohet një vëmendje e veçantë.

Neni 9

55. Ky nen përmban rregulla më të hollësishme se neni 7 për mbrojtjen e lirisë së shprehjes.

Paragrafi 1

56. Fjalja e parë e këtij paragrafi është ndërtuar mbi bazën e fjalisë së dytë të Nenit 10, paragrafi 1, KEDNJ. Ndonëse fjalja i referohet në mënyrë të veçantë lirisë për të marrë dhe shpërndarë informacion dhe ide në gjuhën e pakicës, ajo nënkupton gjithashtu lirinë për të marrë dhe shpërndarë informacion dhe ide në gjuhën e shumicës apo gjuhë të tjera.

57. Fjalja e dytë e këtij paragrafi përmban një angazhim për të siguruar se nuk ka diskriminim në raportet me shtypin. Fjalët "në kuadrin e sistemeve të tyre ligjore" u përfshinë për të respektuar dispozitat kushtetuese që mund të kufizojnë masën në të cilën një Palë mund të rregullojë raportet me shtypin.

Paragrafi 2

58. Ky paragraf është ndërtuar mbi bazën e fjalisë së tretë të Nenit 10, paragrafi 1, KEDNJ.

59. Licensimi i radiopërhapjes dhe televizionit, dhe të ndërmarrjeve kinematografike duhet të jetë mos-diskriminues dhe të mbështetet mbi kritere objektive. Përfshirja e këtyre kërkesave, që nuk janë përmendur shprehimisht në fjalinë e tretë të nenit 10, paragrafi 1, KEDNJ, u konsiderua e rëndësishme për një instrument që synon të mbrojë personat që i përkasin një pakice kombëtare.

60. Fjalët "radio me tinguj", që përmenden edhe në paragrafin 3 të këtij Neni, nuk përmenden në fjalinë përgjegjëse në Nenin 10 KEDNJ. Ato janë përdorur me qëllim që të pasqyrojnë terminologjinë moderne dhe nuk nënkuptojnë ndonjë ndryshim material në kuptim nga Neni 10 KEDNJ.

Paragrafi 3

61. Fjalja e parë e këtij paragrafi, që trajton krijimin dhe përdorimin e shtypit të shkruar, përmban një angazhim pasiv thelbësor, ndërsa fjalja e dytë e formuluar në mënyrë më fleksible thekson një detyrim aktiv në fushën e radiopërhapjes dhe televizionit (psh, caktimi i frekuencave). Ky dallim pasqyron mungesën relative të frekuencave në përdorim dhe nevojën për rregullime në këtë fushë. Asnjë referencë e shprehur nuk është bërë për të drejtën e personave që i përkasin një pakice kombëtare për të kërkuar fonde për ngritjen e shtypit, pasi kjo e drejtë konsiderohet si e qartë.

Paragrafi 4

62. Ky paragraf thekson nevojën për masa të veçanta me qëllim të dyfishtë, për të lehtësuar kontaktet me shtypin për personat që i përkasin pakicave kombëtare dhe nxitjen e tolerancës dhe shumëllojshmërisë kulturore. Shprehja "masa të përshtatshme" përdoret për arsyt e dhëna në komentin mbi Nenin 4, paragrafi 2 (shih paragrafin 39), që ka të njëjtat fjalë. Paragrafi plotëson angazhimin e parashtruar në fjalinë e fundit të Nenit 9, paragrafi 1. Masat e parashikuara nga ky paragraf, për shembull, mund të konsistojnë në financimin e radiopërhapjes së pakicës apo për programe që trajtojnë çështjet e pakicës dhe/apo ofrojnë një dialog ndërmjet grupeve, apo inkurajimit, në varësi të raporteve redaktoriale, të botuesve dhe redaktorëve për t'i lejuar pakicave kombëtare kontakte me shtypin e tyre.

Neni 10

Paragrafi 1

63. Njohja e së drejtës së çdo personi që i përket një pakice kombëtare për të përdorur lirisht dhe pa ndërhyrje gjuhën e tij/saj të pakicës është me rëndësi të veçantë. Përdorimi i gjuhës së pakicës përfaqëson një prej mjeteve themelore nëpërmjet të cilës këta persona mund të pohojnë dhe ruajnë identitetin e tyre. Gjithashtu, ajo i jep mundësi atyre të ushtrojnë lirinë e tyre të shprehjes. "Në publik" do të thotë, për shembull, në një vend publik, jashtë, apo në prani të personave të tjerë, por nuk ka lidhje me ndonjë rrethanë në marrëdhëniet me autoritetet publike, tema e paragrafit 2 të këtij neni.

Paragrafi 2

64. Kjo dispozitë nuk përfshin të gjitha marrëdhëniet ndërmjet individëve që i përkasin pakicave kombëtare dhe autoriteteve publike. Ajo shtrihet vetëm për autoritetet administrative. Megjithatë, këto të fundit, mund të interpretohen gjerësisht, për të përfshirë, për shembull, edhe ombudsmen. Duke pasur parasysh vështirësitë e mundshme financiare, administrative, në veçanti në fushën ushtarake, dhe teknike, që shoqërojnë përdorimin e gjuhëve të pakicës në marrëdhëniet ndërmjet personave që i përkasin pakicave kombëtare dhe autoriteteve administrative, kjo dispozitë është formuluar me shumë fleksibilitet, duke iu lënë Palëve një sferë të gjerë gjykimi.

65. Në momentin që plotësohen dy kushtet në paragrafin 2, Palët do të përpiqen të sigurojnë përdorimin e gjuhës së pakicës në marrëdhëniet me autoritetet administrative, për aq sa është e mundur. Ekzistenca e një "nevoje reale" duhet të vlerësohet nga Shteti mbi bazën e kritereve objektive. Megjithëse Shtetet kontraktuese duhet të bëjnë çdo përpjekje për të zbatuar këtë parim, fjalët "për aq sa është e mundur" tregojnë se faktorët e ndryshëm, në veçanti burimet financiare të Palës përkatëse, mund të merren në konsideratë.

66. Detyrimet e Palëve lidhur me përdorimin e gjuhëve të pakicës nuk ndikojnë në asnjë mënyrë në statusin e gjuhës apo gjuhëve zyrtare të vendit përkatës. Veç kësaj, Konventa kuadër qëllimisht shmang përcaktimin e "zonave të banuara tradicionalisht apo në numër thelbësor nga personat që i përkasin pakicave kombëtare". Me qëllim që t'iu lihen mundësi Palëve që të marrin parasysh rrethanat e veçanta, u gjykua e preferueshme që të miratohej një formë fleksibël formulimi. Termi "të banuara .. tradicionalisht" nuk i referohet pakicave historike, por vetëm atyre që jetojnë akoma në të njëjtën zonë gjeografike (shih edhe Nenin 11, paragrafi 3 dhe Nenin 14, paragrafi 2).

Paragrafi 3

67. Ky paragraf bazohet mbi një sërë dispozitash që parashikohen në nenet 5 e 6 të

Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut. Ai nuk i tejkalon garancitë e parashikuara në këto nene.

Neni 11

Paragrafi 1

68. Duke pasur parasysh pasojat praktike të këtij detyrimi, dispozita është formuluar në mënyrë të tillë që t'u japë mundësi Palëve të zbatojnë atë në dritën e rrethanave të tyre të veçanta. Për shembull, Palët mund të përdorin alfabetin e gjuhës së tyre zyrtare për të shkruar emrin(rat) e një personi që i përket një pakice kombëtare në formën e tij fonetike. Personat që mund të jenë detyruar të mos përdorin emrin(rat) e tyre origjinale, apo emrin(rat) e të cilëve janë ndryshuar me forcë, duhet të kenë të drejtë që t'i kthejnë përsëri, natyrisht në varësi të përjashtimeve në rastin e abuzimit të të drejtave apo ndryshimeve të emrit(rave) për qëllime kriminale. Kuptohet se në këtë drejtim sistemet ligjore të Palëve do të plotësojnë parimet ndërkombëtare lidhur me mbrojtjen e pakicave kombëtare.

Paragrafi 2

69. Në këtë paragraf detyrimi i përket së drejtës së një individi për të shfaqur "në gjuhën e tij/saj të pakicës shenja, mbishkrime dhe informacione të tjera të një natyre private, të dukshme për publikun". Natyrisht, kjo nuk përjashton personat që i përkasin pakicave kombëtare nga kërkesa për të përdorur, veç saj, gjuhën zyrtare dhe/apo gjuhët e tjera të pakicës. Shprehja "të një natyre private" i referohet të gjithë atyre që nuk janë zyrtare.

Paragrafi 3

70. Ky nen synon të nxisë mundësinë për të shkruar në gjuhën e pakicës edhe emrat lokale, emrat e rrugëve dhe tregues të tjerë topografikë, që janë për publikun. Në zbatimin e këtij parimi, Shtetet kanë të drejtë të marrin parasysh në shkallën e duhur rrethanat e veçanta dhe kuadrin e sistemeve të tyre ligjore, përfshirë kur është e përshtatshme edhe marrëveshjet me shtetet e tjera. Në fushën e trajtuar nga kjo dispozitë, kuptohet se Palët nuk kanë detyrimin të përfundojnë marrëveshje me shtete të tjera. Përkundrazi, nuk përjashtohet mundësia e përfundimit të këtyre marrëveshjeve. Gjithashtu, kuptohet se karakteri i detyrueshëm ligjor i këtyre marrëveshjeve mbetet i paprekur. Kjo dispozitë nuk nënkupton ndonjë njohje zyrtare të emrave lokale në gjuhët e pakicës.

Neni 12

71. Ky nen kërkon të nxisë njohjen e kulturës, historisë, gjuhës dhe besimit fetar si të pakicave kombëtare ashtu edhe popullsisë së shumicës në një perspektivë ndërkulturore (shih Nenin 6, paragrafi 1). Qëllimi është krijimi i një klime të tolerancës dhe dialogut, siç referohet në parathënien e Konventës kuadër dhe në Shtojcën II të Deklaratës së Vjenës të Kryetarëve të Shtetit dhe Qeverisë. Lista në paragrafin e dytë nuk është shteruese, ndërsa fjalët "kontakti me tekstet shkollore" kuptohen se përfshijnë botimin e teksteve shkollore dhe blerjen e tyre në vende të tjera. Detyrimi për të nxitur mundësi të barabarta për angazhimin në arsimin e të gjitha niveleve për personat që i përkasin pakicave kombëtare pasqyron një shqetësim në Deklaratën e Vjenës.

Neni 13

Paragrafi 1

72. Detyrimi i Palëve për të njohur të drejtën e personave që i përkasin pakicave kombëtare të krijojnë dhe drejtojnë institucionet e tyre private arsimore dhe kualifikuese i

nënshtrohet kërkesave të sistemit të tyre arsimor, veçanërisht rregullave lidhur me arsimin e detyrueshëm. Institucionet e përfshira nga ky paragraf mund t'i nënshtrohen formave të njëjta të mbikqyrjes si edhe institucionet e tjera, veçanërisht lidhur me standartet mësimore. Pas plotësimit të standarteve të kërkuara, është e rëndësishme që të njihet zyrtarisht çdo kualifikim i dhënë. Legjislacionet kombëtare përkatëse mund të bazohen mbi kritere objektive dhe në përputhje me parimin e mos-diskriminimit.

Paragrafi 2

73. Ushtrimi i së drejtës së referuar në paragrafin 1 nuk sjell ndonjë detyrim financiar për Palën përkatëse, por as nuk e përjashton mundësinë e një kontributi të tillë.

Neni 14

Paragrafi 1

74. Detyrimi për të njohur të drejtën e çdo personi që i përket një pakice kombëtare për të mësuar gjuhën e tij/saj të pakicës i përket një prej mjeteve themelore, me ane të të cilave këta individë mund të pohojnë dhe ruajnë identitetin e tyre. Për këtë nuk mund të kete asnjë përjashtim. Pa çenuar parimet e përmendura në paragrafin 2, ky paragraf nuk nënkupton veprim pozitiv, më konkretisht të një natyre financiare, përsa i përket shtetit.

Paragrafi 2

75. Kjo dispozitë lidhet me mësimin dhe edukimin në një gjuhë pakice. Duke patur parasysh vështirësitë e mundshme financiare, administrative dhe teknike, që shoqërojnë mësimin e apo në një gjuhë të pakicës, kjo dispozitë është formuluar në mënyrë mjaft fleksible, duke i lënë Palëve një masë të gjerë gjykimi. Detyrimi për t'u përpjekur për sigurimin e mësimin të apo në gjuhët e pakicës i nënshtrohet një sërë kushteve; në veçanti, duhet të ketë "një kërkesë të mjaftueshme" nga personat që i përkasin pakicave kombëtare. Formulimi "për aq sa është mundur" tregon se një mësim i tillë varet nga burimet që ka në dispozicion Pala përkatëse.

76. Teksti shmanget qëllimisht nga përcaktimi i "kërkesës së mjaftueshme", një formë fleksible e formulimit që lejon Palët të marrin parasysh rrethanat e veçanta të vendeve të tyre. Palët kanë një opsion të mjeteve dhe rregullimeve për sigurimin e këtij mësimi, duke marrë në konsideratë sistemin e tyre të veçantë arsimor.

77. Alternativat e referuara në këtë paragraf - "mundësitë për të mësuar gjuhën e pakicës apo për të marrë mësim në këtë gjuhë" - nuk përjashtojnë reciprokisht njëratjetrën.

Edhe pse Neni 14, paragrafi 2 nuk vendos detyrime mbi shtetet për t'i bërë të dyja, formulimi i tij nuk pengon Shtetet Palë nga zbatimi i mësimin të gjuhës së pakicës, si edhe edukimin në gjuhën e pakicës. Mësimi dygjuhësh mund të jetë një prej mjeteve për arritjen e objektivave të kësaj dispozite. Detyrimi që rrjedh nga ky paragraf nuk mund të shtrihet në arsimin parashkollor.

Paragrafi 3

78. Mundësitë për të mësuar gjuhën e pakicës dhe edukuar në këtë gjuhë nuk çenojnë mësimin e gjuhës zyrtare apo mësimin në këtë gjuhë. Në të vërtetë, njohja e gjuhës zyrtare është një faktor i kohezionit dhe integritit shoqëror.

79. Iu përket Shteteve ku ka më shumë se një gjuhë zyrtare për të zgjidhur çështjet e veçanta që mund të sjellë zbatimi i kësaj dispozite.

Neni 15

80. Ky nen u kërkon Palëve që të krijojnë kushtet e nevojshme për pjesëmarrjen efektive të personave që i përkasin pakicave kombëtare në jetën kulturore, shoqërore dhe

ekonomike, dhe në çështjet publike, veçanërisht për ato që ndikojnë mbi ta. Qëllimi i tij parësor është të inkurajojë barazinë reale ndërmjet personave që i përkasin pakicave kombëtare dhe atyre që formojnë shumicën. Për të krijuar kushtet e nevojshme për këtë pjesëmarrje nga personat e pakicave kombëtare, Palët do të nxisin në kuadrin e sistemeve të tyre kushtetuese, ndër të tjera, masat e mëposhtëme:

- konsultimin me këta persona, me procedura të përshtatshme dhe ne veçanti, nëpërmjet institucioneve të tyre përfaqësuese, kur Palët synojnë hartimin e legjislacionit apo marrjen e masave administrative që mund të ndikojnë drejtpërsëdrejti mbi ta;
- të angazhojnë këta persona në përgatitjen, zbatimin dhe vlerësimin e planeve dhe programeve të zhvillimit kombëtar e rajonal që mund të ndikojnë drejtpërsëdrejti mbi ta;
- ndërmarrjen e studimeve në bashkëpunim me këta persona, për të vlerësua ndikimin e mundshëm të aktiviteteve të projektuara të zhvillimit mbi ta;
- pjesëmarrjen efektive të personave që i përkasin pakicave kombëtare ne proceset vendim-marrëse dhe organet e zgjedhura në nivele kombëtare e lokale;
- format e decentralizuara apo lokale të qeverisjes.

Neni 16

81. Ky nen ka për qëllim të sigurojë mbrojtjen kundër masave që ndryshojnë raportet e popullsisë në zonat e banuara nga personat që i përkasin pakicave kombëtare dhe synojnë në kufizimin e të drejtave dhe lirive që burojnë nga kjo Konventë kuadër. Shembuj të këtyre masave mund të jenë shpronësimi, konfiskimi dhe dëbimet apo ndryshimi i kufijve administrative me qëllim që të kufizohet gëzimi i këtyre të drejtave dhe lirive ("gerrymandering")

82. Neni ndalon vetëm masat që synojnë në kufizimin e të drejtave dhe lirive që burojnë nga Konventa kuadër. U gjykua e pamundur që të shtrihej ndalimi edhe për masat që ndikojnë në kufizimin e këtyre të drejtave dhe lirive, pasi këto masa shpesh mund të jenë plotësisht të justifikuara dhe legjitime. Një shembull mund të jetë zhvendosja e banorëve të një fshati për të ndërtuar një digë.

Neni 17

83. Ky nen përmban dy angazhime të rëndësishme për ruajtjen dhe zhvillimin e kulturës së personave që i përkasin pakicave kombëtare dhe në mbrojtjen e identitetit të tyre (shih edhe Nenin 5, paragrafi 1). Paragrafi i parë trajton të drejtën për të vendosur dhe mbajtur kontakte të lira dhe paqësore përgjatë kufijve, ndërsa paragrafi i dytë mbron të drejtën për të marrë pjesë në aktivitetet e organizatave jo-qeveritare (lidhur me këtë, shih edhe dispozitat mbi lirinë e grumbullimit dhe shoqërimit në Nenin 7)

84. Dispozitat e këtij neni bazohen gjerësisht në paragrafet 32 . 4 dhe 32 . 6 të Dokumentit të Kopenhagenit të KSBE-së. Përfshirja e një dispozite të drejtpërdrejtë mbi të drejtën për të vendosur dhe mbajtur kontakte brenda territorit të një shteti, u gjykua e panevojshme, pasi mendohej se kjo përfshihej në mënyrën e duhur nga dispozitat e tjera të Konventës kuadër, konkretisht Neni 7 lidhur me lirinë e grumbullimit dhe shoqërimit.

Neni 18

85. Ky nen inkurajon Palët të përfundojnë, përveç instrumenteve ndërkombëtare ekzistuese, dhe kur rrethanat e veçanta e justifikojnë këtë, marrëveshje dypalëshe dhe shumëpalëshe për mbrojtjen e pakicave kombëtare. Ajo nxit edhe bashkëpunimin ndërkufitar. Siç theksohet në Deklaratën e Vjenës dhe Shtojcën II, këto marrëveshje dhe

ky bashkëpunim janë të rëndësishme për nxitjen e tolerancës, përparimit, stabilitetit dhe paqes.

Paragrafi 1

86. Marrëveshjet dypalëshe dhe shumëpalëshe që parashikohen në këtë paragraf, për shembull, duhet të përfundohen në fushat e kulturës, arsimit dhe informacionit.

Paragrafi 2

87. Ky paragraf thekson rëndësinë e bashkëpunimit ndërkufitar. Shkëmbimi i informacionit dhe eksperiencës ndërmjet shteteve është një mjet i rëndësishëm për nxitjen e mirëkuptimit dhe besimit të ndërsjellë. Në veçanti, bashkëpunimi ndërkufitar ka avantazhin sepse lejon rregullime që përshtaten në mënyrë të veçantë ndaj dëshirave dhe nevojave të personave të interesuar.

Neni 19

88. Ky nen parashikon mundësinë e kufizimeve apo shmangieve. Kur angazhimet e përfshira në këtë Konventë kuadër kanë një të barazvlefshëm në instrumente të tjera juridike ndërkombëtare, në mënyrë të veçantë KEDNJ, lejohen vetëm kufizimet apo shmangiet e parashikuara në këto instrumenta. Kur angazhimet e parashtruara në këtë Konventë kuadër nuk kanë të barazvlefshëm në instrumentet e tjera juridike ndërkombëtare, lejohen vetëm ato kufizime apo shmangie, të cilat, të përfshira në instrumentet e tjera juridike (si KEDNJ), janë të përshtatshme lidhur me angazhimet e ndryshme.

PJESA III

Neni 20

89. Personave që i përkasin pakicave kombëtare iu kërkohet të respektojnë kushtetutën kombëtare dhe legjislacionin tjetër kombëtar. Megjithatë, ky referim në legjislacionin kombëtar në mënyrë të qartë nuk iu jep Palëve të drejtën për të injoruar dispozitat e Konventës kuadër. Personat që i përkasin pakicave kombëtare duhet të respektojnë gjithashtu të drejtat e të tjerëve. Në këtë drejtim, duhet referuar në situatat ku personat që i përkasin pakicave kombëtare janë një pakicë në plan kombëtar, por formojnë shumicën brenda një zone të shtetit.

Neni 21

90. Kjo dispozitë thekson rëndësinë e parimeve themelore të së drejtës ndërkombëtare dhe përcakton se mbrojtja e personave që i përkasin pakicave kombëtare duhet të jetë në përputhje me këto parime.

Neni 22

91. Kjo dispozitë, që bazohet në nenin 60 të KEDNJ, parashtron një parim të mirënjohur. Qëllimi është të sigurohet se personat që i përkasin pakicave kombëtare përfitojnë nga cilidoqoftë legjislacion ndërkombëtar apo kombëtar përkatës i të drejtave të njeriut, që është më i favorshëm për ta.

Neni 23

92. Kjo dispozitë trajton marrëdhëniet ndërmjet Konventës kuadër dhe Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut, referenca tek e cila është përfshirë në parathënie. Konventa kuadër nuk mund të ndryshojë në asnjë rrethanë të drejtat dhe liritë e garantuara në Konventën Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut. Përkundrazi, të drejtat dhe liritë e parashikuara në Konventën kuadër, të cilat janë objekt i një dispozite përgjegjëse në Konventën Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut, mund të interpretohet në përputhje me këto të fundit.

PJESA IV

Nenet 24-26

93. Për të siguruar një ndjekje të zbatimit të Konventës kuadër, Komiteti i Ministrave është ngarkuar me detyrën e mbikqyrjes së zbatimit nga Palët Kontraktuese. Komiteti i Ministrave do të vendosë procedurat për pjesëmarrjen në mekanizmin e zbatimit nga Palët, që nuk janë anëtare të Këshillit të Evropës.

94. Çdo Palë do t'i transmetojë Sekretarit të Përgjithshëm, në një mënyrë periodike dhe kurdoherë që këtë e kërkon Komiteti i Ministrave, informacion lidhur me zbatimin e Konventës kuadër. Sekretari i Përgjithshëm do t'ia transmetojë këtë informacion Komitetit të Ministrave. Megjithatë, raporti i parë, që ka për qëllim të sigurojë një informacion të plotë mbi masat legjislative dhe të tjera që kanë marrë Palët për të realizuar angazhimet e parashtruara në Konventën kuadër, duhet të paraqitet brenda një viti pas hyrjes në fuqi të Konventës kuadër lidhur me palën e interesuar. Raportet e mëvonshme do të kenë për qëllim të plotësojnë informacionin e përfshirë në raportin e parë.

95. Për të siguruar efikasitetin e mbikqyrjes së zbatimit të Konventës, ajo parashikon ngritjen e një komiteti këshillimor. Detyra e këtij komiteti këshillimor është të ndihmojë Komitetin e Ministrave kur ai vlerëson përshtatshmërinë e masave të marra nga një Palë për të realizuar parimet e parashtruara në Konventën kuadër.

96. I përket Komitetit të Ministrave të përcaktojë, brenda një viti nga hyrja në fuqi e Konventës kuadër, përbërjen dhe procedurat e komitetit këshillimor, anëtarët e të cilit do të jenë ekspertë të njohur në fushën e mbrojtjes së pakicave kombëtare.

97. Mbikqyrja e zbatimit të kësaj Konvente kuadër, për aq sa është e mundur, do të jetë transparente. Në këtë drejtim, këshillohet të parashikohet botimi i raporteve dhe teksteve të tjera që janë rezultat i kësaj mbikqyrje.

PJESA V

98. Dispozitat përfundimtare që parashikohen në nenet 27 deri 32 bazohen në dispozitat përfundimtare model të konventave dhe marrëveshjeve të arritura në Këshillin e Evropës. Nuk është përfshirë asnjë nen mbi rezervat; rezervat bëhen vetëm në masën që lejohen nga e drejta ndërkombëtare. Veç neneve 27 dhe 29, nenet e kësaj Pjese nuk kërkojnë koment të veçantë.

Nenet 27 dhe 29

99. Konventa kuadër është e hapur për nënshkrim nga shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, dhe me ftesë të Komitetit të Ministrave, edhe nga shtetet e tjera. Kuptohet se "shtete të tjera" janë ato shtete që marrin pjesë në Konferencën mbi Sigurimin dhe Bashkëpunimin në Evropë. Këto dispozita marrin parasysh Deklaratën e Vjenës, sipas së cilës Konventa kuadër duhet të jetë e hapur për nënshkrim edhe nga shtetet jo-anëtare (shih Shtojcën II të Deklaratës së Vjenës të Takimit të Nivelit të Lartë të Këshillit të Evropës).